



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

C.nr.367/22

Nr. Smil: 2021: 286950

GJYKATA THEMELORE GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Gentiana Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Ronita Halimi, në çështjen kontestimore të paditësit B.Bnga fshati R., K/K, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Arbër Istrefi nga Prishtina, ndaj të paditurës M.M.P.H.I, me objekt kontesti padi për kompensimin e dëmit në lartësi prej 818.00 Euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, me datë 16.01.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit B.Bnga fshati R., K/K, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura M.M.P.H.I, që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 818.00 Euro, me kamatë vjetore në lartësinë prej 8 %, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.
- II. Secila palë i bartë për vete shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Fillimisht paditësi B.Bnga fshati R., K/K, më datë 21.12.2021, ka dorëzuar në gjykatë padi për kompensimin e dëmit kundër të paditurës M.M.P.H.I, dhe ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit për dëmin material të shkaktuar në automjetin e tij të udhëtarëve Audi 8U me targa ---, më 09.10.2021, në magjistralen H.E.-K., afër Tunelit të Parë-K., si pasojë e shembjes së gurëve në rrugë, t'ia paguaj shumën prej 1,000.00 Euro, për shkak të mosmirëmbajtjes së rregullt të rrugës nga e paditura, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë gjer në pagesën përfundimtare.

Paditësi në padi ka theksuar se më datë 09.10.2021, rreth orës 14:15, në rrugën magjistrale H.E.-K., afër Tunelit të Parë-K., është shkaktuar fatkeqësia e komunikacionit në të cilën dëm material në automjetin e tij të udhëtarëve Audi 8U me targa --- ka pësuar paditësi B.BMë tej në padi ka theksuar se fatkeqësia është shkaktuar kur ngasësja e automjetit të lartcekur V.L., e cila qarkullonte në magjistralen H.E.-K., me të arritur afër Tunelit të parë-K., një pjesë e rrugës ishte

e mbushur me gurë të shembur nga kodra, ana e djathtë, dhe për një moment një guri i kishte rënë në kapakun e motorit të automjetit. Nga shembja e gurëve, dëm material në automjetin e tij të udhëtarëve Audi 8U me targa --- ka pësuar paditësi B.BPaditësi në padi pretendon se e paditura M.M.P.H.I, është përgjegjëse për shkaktimin e dëmit paditësit, pasi që nuk ka vepruar ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, neni 9 paragrafi 1 ku thuhet: *“Rruga në të cilën zhvillohet trafiku duhet të projektohet, të ndërtohet, të pajiset, të mirëmbahet dhe të mbrohet, në mënyrë që t’i përgjigjet qëllimit të vet dhe kërkesave të sigurisë së trafikut, në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi Rrugët dhe me dispozitat e këtij ligji”*. Në rastin konkret, e paditura nuk ka vepruar ashtu siç përcaktohet me dispozita ligjore edhe pse ka pasur për obligim që rruga ku zhvillohet trafiku të mirëmbahet dhe të mbrohet.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me parashtresën e datës 17.12.2024, e ka precizuar lartësinë e kërkesëpadinë së paditësit, duke kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësit t’ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 818.00 Euro, me kamatë vjetore në lartësinë prej 8 %, sipas nenit 382 të LMD-së, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare.

Përfaqësuesi i paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me provat e administruara është argumentuar mjaftueshëm baza juridike e kërkesëpadisë dhe përgjegjësia e të paditurës për dëmet e pësuar në automjetin e paditësit për shkak të mos mirëmbajtjes së duhur të rrugës magjistrale K.-H.E.. Legjitimiteti pasiv i të paditurës buron nga Ligji për rregullat e trafikut rrugor neni 9 par.1 në ndërlidhje me nenin 202 par.1 të të njejtit ligj si dhe Ligjit nr.2003/11 për Rrugët neni 21 shtojca 32.2 pika K i cili nen e bën përgjegjës Ministrinë për mënjanimin e të metave në rrugë e të gjitha këto të ndërlidhur me LMD neni 136, 173 par.1 dhe par.2. Andaj, nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë e precizuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

E paditura, në përgjigje në padi, përmes të autorizuarit të saj, ka deklaruar se e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit nga fakti se në këtë çështje juridike i mungon legjitimiteti real pasiv për t’u paraqitur si palë në këtë procedurë. Më tej ka theksuar se në këtë rast kemi të bëjmë me një rrethanë të paparashikuar, më saktësisht kemi të bëjmë me fuqi madhore-vis majoris, duke shtuar se edhe sikur të kishim të bëjmë me një rrethanë të parashikuar si në rastin konkret, nga deklarata e paditësit vërtetohet saktë se guri mbi veturë ka qenë deri sa vetura ishte duke lëvizur, duke bërë kështu që kjo goditje të vie si pasojë e fuqisë madhore-vis majoris, dhe në rastin konkret e paditura nuk është ajo e cila do duhet t’ua kompensonte dëmin e shkaktuar, pasi që për mirëmbajtjen e rrugëve e paditura ka kontraktuar kompani të ndryshme, por në këtë rast nuk kemi të bëjmë me mosmirëmbajtje të rrugës por me një rrethanë të paparashikuar për të cilën nuk mban askush përgjegjësi. Andaj, bazuar nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Për të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike kontestimore, si dhe për t’i vlerësuar faktet kontestuese mes palëve ndërgjyqëse, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave:

- Raporti i policisë nr.2021-CFF- 639 i dt 09.10.2021, pa skicim sepse sipas raportit të policisë shkruan që njësia 2 ka lëshuar vendin e ngjarjes;
- Raporti i policit hetues i dt 09.10.2021;
- Kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje me nr. të rastit 2021-CFT- 639 e dt 09.10.2021;
- Përshkrimi i vendit të ngjarjes i dt 09.10.2024;
- Fotografitë e automjetit pas dëmit;
- Deklarata me nr. të rastit 2021-CFT- 639 e dt 12.10.2021 e dhënë nga V.L.;
- Informacioni - raporti intelgjent me nr. të rastit OL-2021-CFT- 4165 i dt 09.10.2021;
- Libreza e qarkullimit në emër të B.Bme nr. të regjistrimit të automjetit 05-123 FF
- Kopja e patent shoferit për V.L.;
- Kopja e letërnjoftimit të B.B;
- Polica e sigurimit në emër të B.Bpër periudhën e sigurimit 30.09.2021 deri me 30.09.2022;
- Ekspertiza e komunikacionit e dt 13.11.2024 dhe ekspertiza e makinerisë e dt 13.11.2024;
- Dëgjimi i ekspertit të makinerisë në seancën e shqyrtimit kryesor e dt 16.12.2024.

Gjykata, pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara si më lartë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tani e tutje LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Nga pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje juridike kontestimore, si çështje kontestuese mes palëve është përgjegjësia e të paditurës lidhur me dëmin material të shkaktuar në automjetin e paditësit Audi 8U me targa ---, i cili dëm është shkaktuar kur ngasësja e automjetit të lartcekur V.L., e cila qarkullonte në magjistralen H.E.-K., me të arritur afër Tunelit të parë-K., për një moment një guri i kishte rënë në kapakun e motorit të automjetit të paditësit, i cili dëm sipas pretendimeve të paditësit është shkaktuar si pasojë e mos veprimit të të paditurës.

-Nga Raporti i policisë nr.2021-CFF-639 i dt 09.10.2021, gjykata konstaton se me datë 09.10.2021 rreth orës 14:15 ka ndodhur aksident me dëme materiale, në lokacionin Rruga Magjistrale Tuneli i Parë në K.. Raporti i policisë është pa skicim sepse sipas këtij raporti njësia 2 ka lëshuar vendin e ngjarjes.

-Nga Raporti i policit hetues i dt 09.10.2021, gjykata konstaton se ka ndodhur aksident trafiku me dëme materiale, dhe njësitë e përfshira në aksident kanë qenë njësia një: Ministria e Infrastrukturës në P., dhe njësia dy: Automjeti Audi 8U ngjyrë e bardhë me targa 05-123-FF, të cilin e kishte drejtuar V.L. e lindur me datë 05.03.1985 nga fshati R.-K..

-Nga Kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje me nr. të rastit 2021-CFT- 639 e dt 09.10.2021, gjykata konstaton se Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në Ferizaj, ka paraqitur kërkesë për kundërvajtje ndaj të paditurës Ministria e Infrastrukturës, me adresë ish-Ndërtesa e Gërmisë në P., si pasojë e mos mirëmbajtjes (sigurimit) të rrugës magjistrale nga

Ministria e Infrastrukturës, nga shembja e gurëve është shkaktuar aksident trafiku me dëme materiale në automjetin Audi 8U ngjyrë e bardhë me targa 05-123-FF.

-Nga Përshkrimi i vendit të ngjarjes i dt 09.10.2024, gjykata konstaton se në datën, orën dhe lokacionin e lartcekur, ka ndodhur aksident trafiku me dëme materiale, ku ishte përfshirë një njësi si pasojë e shembjeve të gurëve në rrugë. Në raport theksohet se bazuar në deklaratën e vozitëses së njësisë dy, deri te aksidenti kishte ardhur kur njësia dy ishte duke qarkulluar në rrugën magjistrale H.E.-K., dhe me të arritur para Tunelit të Parë (afër K.ut, një pjesë e rrugës ishte e mbushur me gurë të shembur, të cilët gurë ishin shembur nga kodra nga ana e djathtë e drejtimit të njësisë dy, si dhe për një moment një guri i kishtë rënë në kapakun e motorrit të automjetit, me ç'rast ishte shkaktuar dëm material në automjet.

-Nga Fotografitë e automjetit pas dëmit, gjykata konstaton se automjeti i tipit audi, ngjyrë e bardhë, me targa 05 123-FF, është i dëmtuar në pjesën e përparme.

-Nga Deklarata me nr. të rastit 2021-CFT- 639 e dt 12.10.2021 e dhënë nga V.L., gjykata konstaton se e njejta me datë 12.10.2021 në ora 15:35, ka dhënë deklaratë në Stacionin Policor në Ferizaj, lidhur me aksidentin e ndodhur.

-Nga Informacioni - raporti intelgjent me nr. të rastit OL-2021-CFT- 4165 i dt 09.10.2021, gjykata konstaton se ankuesi i cili ka mbetur anonim, ka njoftuar se shoqja e tij ka qenë me veturë të H.E.-K., dhe i është dëmtuar vetura prej gurëve.

-Nga Libreza e qarkullimit në emër të B.Bme nr. të regjstrimit të automjetit 05-123 FF, gjykata konstaton se automjeti i tipit Audi 8U ngjyrë e bardhë me targa 05-123-FF, i cili ka qenë objekt i aksidentit, është në pronësi të paditësit B.B

-Nga Kopja e patent shoferit për V.L., gjykata konstaton se e njejta posedon patent shofer valid të Republikës së Kosovës.

- Nga Kopja e letërnjoftimit të B.B, gjykata konsaton se i njejti posedon letërnjoftim valid të Republikës së Kosovës.

- Nga Polica e sigurimit në emër të B.B, gjykata konstaton se automjeti i aksidentuar Audi 8U ngjyrë e bardhë me targa 05-123-FF, në momentin e aksidentit ka qenë i siguruar në Kompaninë e Sigurimeve "SIGURIA", dhe i njejti ka pasur sigurim valid nga data 30.09.2021 deri me datë 30.09.2022.

-Nga Ekspertiza e komunikacionit e dt 13.11.2024, gjykata konstaton se deri te ky aksident i komunikacionit rrugor kishte ardhur përderisa shoferja me automjetin B (Audi) ishte duke lëvizur në rrugën: H.E. – K., dhe me të arritur para tunelit të parë në K. një pjesë e rrugës ishte e mbushur me gurë të shembur të cilët kishin rënë nga kodra nga ana e djathtë ku me ç'rast një guri i bie mbi kapakun e motorit duke e dëmtuar dhe në këtë mënyrë shkaktohet aksident komunikacion rrugor.

-Nga Ekspertiza e makinerisë e dt 13.11.2024, gjykata konstaton se tek automjeti Audi 8U me targa ---, është shkaktuar dëm material në pjesën e përparme, ndërsa riparimi i këtij automjeti është teknikisht i mundur dhe ekonomikisht i arsyeshëm. Sipas ekspertizës vlera e përgjithshme

e shpenzimeve për riparimin e automjetit të lartcekur në kohën e ndodhjes së dëmit, tetor 2021, do të ishte 818.00 Euro.

-Nga dëgjimi i ekspertit të makinerisë në seancën e shqyrtimit kryesor e dt 16.12.2024, gjykata konstaton se me rastin e llogaritjes së dëmit çmimi i pjesëve dhe normativi i punës duhet dhe janë llogaritur si në periudhën e ndodhjes së aksidentit, në këtë rast tetor 2021.

Lidhur me pretendimet e lartcekura, neni 136 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, parasheh se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë të kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, ndërsa me nenin 140 të këtij Ligji përcaktohet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”*.

Nga provat e administruara gjykata vlerësoi se në këtë çështje juridike kontestimore, nuk u vërtetua bazueshmëria e kërkesëpadisë dhe përgjegjësia e të paditurës, ngase provat të cilat u administruan nga ana e gjykatës sipas propozimit të palës paditëse, gjykata i vlerësoi si të pamjaftueshme dhe jo bindëse në aspektin e vërtetimit të fakteve vendimtare mbi bazën e të cilave gjykata do të vendoste lidhur me kërkesëpadinë e paditësit në lidhje me kompensimin e dëmit material dhe përgjegjësinë e të paditurës për shkaktimin e dëmit. Në këtë korelacion, gjykata pas vlerësimit të konstatimeve në ekspertizën e komunikacionit të datës 13.11.2024, ia fali besimin të njejtës, pasi ekspertiza në fjalë është punuar në mënyrë profesionale nga eksperti i komunikacionit, dhe sipas tij në rastin konkret, është konstatuar se shkak i ndodhjes së aksidentit të komunikacionit rrugor është “Faktori Rrugë” si pasojë e rënies së gurëve nga ana e djathtë e terrenit malor skaj rrugës magjistrale M2: “H.E.-K.”. Më tej eksperti ka konstatuar se rënia e gurëve në rrugë ka qenë momentale dhe e paparashikueshme për shoferen e automjetit B në momentin e ndodhjes së rastit, andaj në përputhje me konstatimin e ekspertit të komunikacionit, gjykata vlerëson se nuk ka bazë të mjaftueshme për të konstatuar përgjegjësinë e të paditurës lidhur me dëmin e shkaktuar si pasojë e rënies së gurëve në automjetin e paditësit, ngase eksperti mendimin dhe konstatimin e tij e ka dhënë mbi bazën e dokumentacionit përkatës në lëndë, nga të dhënat mbi rrugën dhe kohën e aksidentit, si dhe nga deklarata e shoferes së automjetit e dhënë para Policisë, andaj këto të dhëna sipas vlerësimit të gjykatës ishin të pamjaftueshme për të konstatuar përgjegjësinë e të paditurës lidhur me dëmin e shkaktuar.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e paditësit lidhur me përgjegjësinë e të paditurës për mirëmbajtjen e rrugës sipas Ligjit për rregullat e trafikut rrugor neni 9 par.1 në ndërlidhje me nenin 202 par.1 të të njejtit ligj si dhe Ligjit nr.2003/11 për Rrugët neni 21 shtojca 32.2 pika K, i cili nen sipas paditësit e bën përgjegjës të paditurën Ministrinë për mënjanimin e të metave në rrugë e të gjitha këto ndërlidhur me nenin 136, 173 par.1 dhe par.2 të LMD-së, mirëpo pretendimet e tilla i gjeti si të pa bazuara, ngase gjykata vlerëson se në rastet kur pretendohet shkaktimi i dëmit duhet të plotësohen në mënyrë kumulative disa kushte, dhe atë: a) duhet të ekzistoj dëmi i shkaktuar, b) dëmi të shkaktohet si pasojë e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit, c) duhet të ekzistoj faji, dhe d) duhet të ekzistoj lidhja kauzale në mes të veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të shkaktuar.

Rrjedhimisht, në rastin konkret, nuk është përmbushur elementi i lidhjes kauzale apo shkakore, që do të sillte pas vetes edhe përgjegjësinë për fajin, për faktin se sipas deklaratës së datës

12.10.2021 e dhënë nga V.L., përkatësisht ngasësja e automjetit të dëmtuar të paditësit, si dhe provave tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, dëmi material i shkaktuar në automjetin e paditësit ka ardhur si pasojë e rënies së gurëve nga kodra në automjetin e paditësit përderisa ngasësja e automjetit ka qenë duke lëvizur me automjet, përkatësisht nga forca madhore, prandaj është e pamundur që e paditura ta evitoj rënien e gurëve, ngase forca madhore nënkupton të gjitha dukuritë dhe ndodhitë e jashtme, të cilat nuk kanë mundur të parashikohen, të mënjanohen apo të evitohen, e të cilat kanë ndikuar në shkaktimin e dëmit, andaj gjykata vlerëson se në rastin konkret përgjegjësia për shkaktimin e dëmit nuk bie mbi të paditurën, për faktin se edhe nga provat e bashkangjitura nga e paditura me përgjigjen në padi, siç është shkresa elektronike e datës 09.09.2022 e lëshuar nga ana e të paditurës, si dhe nga fotografitë e bashkangjitura nga e paditura të cilat janë nga vendi ku ka ndodhur ngjarja, gjykata konstaton se e paditura në aksin K.-H.E. ka vendosur shenjat adekuate të komunikacionit, konkretisht shenjën e zonës së shembjes së gurëve, dhe shenjën e kufizimit të shpejtësisë 50 km në orë, andaj nga të gjitha provat dhe shkresat e lëndës rezulton se e paditura ka ndërmarrë masa parandaluese për evitimin e shkaktimit të dëmit, dhe ndërlidhur me të lartcekurat gjykata ka ardhur në përfundim se shkaktimi i dëmit material në automjetin e paditësit ka qenë momental nga guri i rënë nga kodra përderisa automjeti ishte duke lëvizur, prandaj e paditura në asnjë mënyrë nuk ka pasur mundësi që ta parashikoj, ta mënjanoj apo ta evitoj dukurinë e rënies së gurit në automjetin e paditësit.

Për më tepër, lidhja kauzale paraqet marrëdhënien reciproke midis veprimit të dëmshëm dhe dëmit, ku veprimi i dëmshëm është shkaku dhe dëmi është pasoja e tij. Pra, lidhja kauzale është një nga kushtet kryesore për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, e cila ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Në rastin konkret, lidhja kauzale duhet të jetë e tillë që të dëshmojë qartë se ngjarja është shkaktuar si pasojë e mosveprimit të të paditurës.

Dispozita e nenit 154 është një ndër dispozitat e LMD-së në të cilat parashikohet përgjegjësia objektive. Ajo parashikon përgjegjësinë për dëmin i cili rrjedh nga sendi i rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme. Nga praktika gjyqësore konstatohet se send i rrezikshëm mund të jetë sendi i luajtshëm ose i paluajtshëm, i cili nga vetë ekzistimi i tij, nga vetitë që ka, për nga pozita apo përdorimi i tij, përfaqëson rrezikshmëri të shtuar për rrethin, prandaj i duhet kushtuar vëmendje e posaçme, veçanërisht me rastin e përdorimit. Parimisht, tek përgjegjësia objektive, personi përgjegjës nuk mund të lirohet nga përgjegjësia duke provuar se nuk është fajtor. Mirëpo, në raste të caktuara ai mund t'u referohet disa rrethanave të veçanta, të pranuar me ligj, ekzistimi i të cilave bën të mundur të lirohet nga përgjegjësia. Në këto rrethana bëjnë pjesë: fuqia madhore (vis maior), veprimi i të dëmtuarit dhe veprimi i personit të tretë. Në rastin konkret, edhe pse paditësi nuk arriti të argumentoj bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata në raport pretendimet e paditësit, i cili ka deklaruar se dëmi i është shkaktuar si pasojë e rënies së gurit në automjetin e tij për shkak të mos mirëmbajtjes së rrugës nga ana e të paditurës, e vlerësoi të drejtën materiale, lidhur me përgjegjësinë e të paditurës në rastin konkret. Lidhur me këtë, e mbi bazën e pretendimeve të vet paditësit, gjykata vlerëson se duhet të zbatohet neni 158 paragrafi 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili parasheh se: *“Zotëruesi lirohet nga përgjegjësia në rast se provohet se dëmi rrjedh nga ndonjë shkak që ka ndodhur jashtë sendit dhe efekti i të cilit nuk ka mundur të parashihet, të mënjanohet ose të evitohet”*. Në lidhshmëri me këtë, dispozita ligjore e lartcekur ka paraparë se në raste të caktuara, duke u bazuar në rrethana të veçanta, lirimin nga

përgjegjësia, e në këto rrethana bën pjesë edhe fuqia madhore. Bazuar në këtë dispozitë, gjykata vlerëson se e paditura nuk bartë përgjegjësi për kompensimin e dëmit në raport me paditësin, kjo për faktin se e paditura, lirohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga guri si send i rrezikshëm, dhe mbi këtë bazë gjykata vlerëson se dëmi i pretenduar rrjedh nga shkak i forcës madhore që ka ndodhur jashtë sendit-automjetit dhe efekti i atij shkak nuk ka mundur të parashikohet, të mënjanohet dhe të evitohet. Se dëmi i pretenduar nga paditësi në automjetin e tij, është shkaktuar nga gurët të cilët kishin rënë nga kodra, nuk ishte kontestuese as për paditësin, e po ashtu, kjo vërtetohet edhe nga Raporti i policit hetues i dt 09.10.2021, dhe nga Përshkrimi i vendit të ngjarjes i dt 09.10.2024.

Nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastet e paraqitjes së kërkesave për dëmshpërblim në bazë të përgjegjësive objektive, personi përgjegjës, në cilësinë e palës së paditur, nëse konsideron se ekzistojnë rrethana jashtë sendit apo veprimtarisë të cilat nuk kanë mundur të parashikohen, mënjanohen apo evitohen, ai e ka edhe barrën e të provuarit të kësaj për çka edhe ka ofruar prova të mjaftueshme, të cilat në situatën konkrete dëshmojnë qartë se rrethanat jashtë sendit nuk kanë mundur të parashikohen, mënjanohen apo evitohen për shkak të mënyrës se si ka ndodhur ngjarja, e cila ka qenë momentale, e papritur, dhe e pa evitueshme. Andaj, gjykata vlerëson se në këtë proces kontestimor, pala paditëse nuk arriti të argumentojë apo provoj se me mosveprimet e të paditurës, është shkaktuar dëmi apo pasoja, ashtu siç përcaktohet me nenin 136 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në lidhshmëri me të provuarit, neni 319 paragrafi 1 i LPK-së, parasheh se secila palë ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, andaj, nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se paditësi nuk ka mundur të argumentoj të drejtën e tij dhe detyrimin e të paditurës për kompensimin e dëmit material.

Njëkohësisht, paditësi nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme konstatimin e lartcekur, lidhur me atë se nëse e paditura ka pasur mundësi ta evitoj një dëm të cilin e pretendon, si dëm i shkaktuar me mosveprim nga e paditura, përkatësisht nga mos mirëmbajtja e rrugës siç pretendon paditësi, e ku i njejti ka pasur mundësi gjatë gjithë procedurës të argumentoj me fakte apo prova se mos mirëmbajtja e rrugës si pasojë e të cilës pretendon se është shkaktuar dëmi, ka qenë shkaktar i dëmit të pretenduar, ku për më tepër një pretendim i tillë i paditësit bie ndesh me raportin e ekspertizës së komunikacionit e datës 13.11.2024, ngase sipas këtij raporti bazuar në rrjedhën e aksidentit të përshkruar nga ana e policit hetues në vendin e ngjarjes, rruga ka qenë e qarkullueshme për automjete deri në momentin para aksidentit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, e në përputhje me paragrafin 2 të nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, gjykata përmes provave të administruara arriti të vërtetoj gjendjen faktike, dhe gjeti se nuk është arritur të konstatohet se e paditura ka përgjegjësi për kompensimin e dëmit material ndaj të paditurës, për çka vendosi sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata kishte parasysh edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo, të njëjtat nuk ishin relevante dhe nuk kishin ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje kontestuese.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, ku secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale, dhe atë duke u bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së, duke marr parasysh suksesin e palëve në procedurë, ku pala paditëse i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe i ka specifikuar të njejtat, mirëpo e njëjta e ka humbur kontestin, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, për çka edhe gjykata vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e neneve 142 dhe 143 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**

**C.nr.367/22
Me datë: 16.01.2025**

**Gjyqtarja,
Gentiana Shabani**

Udhëzim mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në P., përmes kësaj gjykate.